



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 24, datë 26.02.2018

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN
NR. 58, DATË 30.06.2015 “MBI MASAT E VIGJILENCËS SË DUHUR DHE TË
ZGJERUAR NGA SUBJEKTET E LIGJIT MBI PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË
PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”, E NDRYSHUAR

Në zbatim të rekomandimeve të lëna nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës (KiE), me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Në Rregulloren nr. 58, datë 30.06.2015 “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, e ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1.1 Titulli i nenit 11 “Dispozita Kalimtare” bëhet “Dispozita të tjera”;

1.2 Në nenin 11 shtohen paragrafët si më poshtë:

“Subjektet raportojnë pranë Autoritetit mbi baza vjetore të dhënat e kërkuara sipas Anekseve 4 dhe 5, bashkëngjitur kësaj rregulloreje, brenda 30 ditëve pas mbylljes së vitit kalendarik.”

“Subjektet e kësaj rregulloreje raportojnë të dhënat për vitin 2017 sipas Anekseve 4 dhe 5 brenda datës 30 prill 2018.”

2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI